



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS“
HASAN PRISHTINA” UNIVER
SITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10000 Prishtinë, Republikë e Kosovës Tel: +381 38 244 183 E-mail: rektorati@uni-pr.edu www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Lavërtari Perimtari

Programi: Shkenca Bimore

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 ekësaj rregulloreje, ju njoftojmë:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bleona Haradini** me titull: **“NDIKIMI I POLIETILEN GLIKOL-IT (PEG) NË STRES TË PIGMENTIT FOTOSINTETIK TË FASULES (*PHASEOLUS VULGARIS* L.)** Ndikimi i polietilen glikolit (peg 6000) në stres të fara e fasules (*Phaseolus vulgaris* L.)

Punimi ndodhet në diskutim publik.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisionin e përbërje:

1. Prof. Dr. Imer Rusinovci kryetar
2. Prof. Dr. Sali Aliu-Mentor
3. Prof. Dr. Skënder Kaçiu anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund të kërkonit te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Sali Aliu përmes e-mail adresës: Sali.aliu@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurimi punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS ‘‘HASAN PRISHTINA’’
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
STUDIMET MASTER
Departamenti ‘‘Shkenca Bimore’’



)

NDIKIMII POLIETILEN GLIKOL-IT (PEG)
NËSTRESTËPIGMENTITFOTOSINTETIKTËFASULES (*PHASEOLUS VULGARIS L.*).
PUNIM MASTER (MASTER THESIS)

MENTORI

Prof.Dr.SaliALIUBsc.

STUDENTJA

Bleona HARADINI

Prishtinë2024

Absrakti:

Burimi kryesor i energjisë për pothuajse të gjithë jetën është Dielli. Energjia në rrezët e diellit futet në biosferë nga një proces i njohur si fotosinteza, i cili ndodhet tek bimët, algat dhe disa lloje bakteriesh. Ky proces është thelbësor për prodhimin e oksigjenit dhe krijimin e ushqimit që mbështet shumicën e ekosistemeve. Gjatë fotosintezës, drita diellore konvertohet në energji kimike, e cila ruhet në molekulat e glukozës dhe shpërndahet më pas në mënyrë që të përdoret nga organizmat e tjera. Ky mekanizëm është një faktor kyç për ruajtjen e balancës ekologjike dhe për zhvillimin e cikleve të ndryshme biologjike që përfshijnë individë dhe grupe organizmesh. Nëpërmjet këtij procesi, fotosinteza siguron jo vetëm ushqim për bimët dhe organizmat që ushqehen prej tyre, por edhe mbështetje për atmosferën dhe klimën e Tokës. Prandaj, studimi i fotosintezës është i rëndësishëm për kuptimin e proceseve natyrore dhe mund të ofrojë mundësi për zhvillimin e burimeve të energjisë alternative dhe të qëndrueshme. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizohet por edhe të identifikohet efekti dhe ndikimi i stresit në bimë i indukuar nga një substance e quajtur PEG (Polietilen Glikol), trajtimet ishin me doza dhe tretmane të ndryshme të cilat janë të përshkruar në detaje të materiali dhe metoda e punës. Hulumtimi është realizuar në laboratorin e përmirësimit gjenetik të bimëve, departamenti Shkenca Bimore, Fakultetit i Bujqësisë dhe Veterinarisë Universiteti i Prishtinës – Prishtinë. Ky hulumtim është zhvilluar gjatë periudhës Korrik – Korrik 2024. PEG është përgatitur me dy përqendrime të ndryshme me 10% dhe 15%. Një nga aplikimet e mundshme është përdorimi i tij në kultivimin e fasulës, ku PEG 6000 mund të përdoret për të rritur tolerancën ndaj stresit abiotik, si thatësira dhe temperatura ekstreme. Këtu studim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e PEG 6000 në rritjen, zhvillimin dhe rendimentin e fasulës, si dhe efektet e tij mbi parametrat fiziologjikë dhe biokimikë të bimës. Përdorimi i PEG6000 si një agjent osmoprotektiv mund të ndihmojë në reduktimin e dëmeve të shkaktuara ngakushte të vështira mjedisore, duke përmirësuar aftësinë e bimëve për të ruajtur ujë dhe për të mbijetuar në kushte të tilla. Ky abstrakt shqyrton gjithashtu mundësitë e përdorimit të

PEG 6000 në përmirësimin e cilësisë së fasulës, duke analizuar ndikimin e tij në përmbajtjen e lëndëve ushqyese dhe elementëve të tjerë që kontribuojnë në vlerën ushqimore. Ky hulumtim është irëndësishëm për zhvillimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore dhe mund të ofrojë zgjidhje përpërballimin e sfidave të prodhimit të fasules në kushte të ndryshueshme klimaterike.

Fjalet Kyçe: PEG 6000, Thatësira, Stresi Abiotik, Fotosinteza.

